




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0032137-26/03-06-2026
Mitrovicë


Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0076607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 15, 34 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, nenin 5 paragrafi 3 të Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, Kërkesën elektronike dt. 10.06.2026 nga GIZ- Kosova, si dhe Propozim – Vendimin e Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit Nr. 01-020/04-0032137/26, 03.06.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Grupit Teknik në kuadër të Trupit të Përbashkët Punues për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (TPPMIM) në Rajonin e Komunës së Mitrovicës së Jugut)

1. **Formohet** Grupi Teknik në kuadër të Trupit të Përbashkët Punues për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (TPPMIM) në Rajonin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Irfan Peci – kryesues (Drejtorja për Mbrojtje të Mjedisit);
 - 1.2. Bahri Sinani – anëtar (Drejtorja për Mbrojtje të Mjedisit);
 - 1.3. Vlora Bejta – anëtare, (Drejtorja për Mbrojtje të Mjedisit);
 - 1.4. Ibadete Sylva Voca – anëtare, (Drejtorja për Mbrojtje të Mjedisit);
 - 1.5. Blerta Dragaj – anëtare, (Drejtorja për Mbrojtje të Mjedisit);
 - 1.6. Gonxhe Prekazi – anëtare, (Drejtorja për Buxhet dhe Financa);
 - 1.7. Tafil Peci – anëtar, (KRM "UNITEFI");
 - 1.8. Ermira Delija – anëtare, (KRM "UNITEFI");
 - 1.9. Artan Ibishi – anëtar, (Drejtorja për Inspektion);
 - 1.10. Bedri Bajrami – anëtar, (Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural).
2. Grupi Teknik i lartcekur obligohet të sigurojë Hartimin e Dokumenteve Themelore: Hartimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe udhëzimet përkatëse, të kontribuoj në Hartimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndërkomunal për TPPMIM-in, të bashkëpunoj ngushtë me grupet punuese teknike të Komunave të Moshtrisë dhe Skenderaj.

3. Grupi Teknik obligohet të bëjë Monitorimin dhe Zbatimin e PNKMIM-ve, të kryej rishikime periodike të progresit dhe të përfilloj sfidat dhe pengesat në procesin e zbatimit, të harmonizoj rregulloret komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në pajtim me PNKMIM-ve dhe monitorimin e punës operative për mbeturinat e përziera dhe ato të riciklueshme.
4. Grupi Teknik obligohet të koordinoj punën me organizatën gjermane GIZ- Zyra në Kosovë, si lehtësuese e procesit, si dhe me të tjera të interesit përfshirë institucionet përkatëse.
5. Grupi Teknik obligohet që të hartoj raport vjetor të konsoliduar duke përmbledhur të dhëna, informacione, arritjet, sfidat dhe rekomandimet për menaxhimin e mbeturinave dhe të njëjtin ta dorëzoj Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit, Kryetarit të Komunës dhe Ekipit Drejtues në nivel regjional.
6. Grupi Teknik i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
7. Mandati i Grupit Teknik të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shërbëhet Vendimi Nr. 01-020/04-0077764-2/22, dt. 26.08.2022.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


 Kryetari i Komunës
 Faton PEÇI

Shtojcë:

- Ix1 Propozim - Vendimin e Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit, Ligje Nr. 01-020/04-0032137/26, 03.06.2026.
- Ix1 Vendimi Nr. 01-020/04-0077764-2/22, dt. 26.08.2022.
- Ix1 Kërkesa elektronike nga GIZ- Kosova, dt. 10.06.2026.

T'i dërgohet:

- Ix1 Kryetari të Komunës
- Ix1 Zyrës Ligjore
- Ix1 Zyrës për Informim
- Ix1 Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit
- Ix1 Anëtarëve të Grupit teknik
- Ix1 Arkivi